



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I EDUKIMIT

# DORACAK PËR STUDIMET E DOKTORATËS

PRISHTINE, 2017



Universiteti i Prishtinës  
Fakulteti i Edukimit

# ***Doracak për Studimet e Doktoratës***

Prishtinë, 2017

## PËRMBAJTJA

<b>I. HYRJE</b>	<b>3</b>
Korniza e programit të doktoratës	4
Modulet e studimit të orientimit (kandidatët i zgjedhin 2 module):	6
Modulet zgjedhore - (kandidatët i zgjedhin 3 module: 3x5 ECTS)	6
Kriteret për përfundimin e programit të studimeve të doktoratës	7
<b>II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E STUDIMEVE TË DOKTORATËS</b>	<b>9</b>
1. Përgjegjësitë e Dekanatit	9
2. Këshilli i studimeve të doktoratës	9
3. Shërbimi/zyra për studimet e doktoratës	10
<b>III. SHKRIMI DHE MIRATIMI I PROPOZIMEVE PËR KËRKIME</b>	<b>11</b>
1. Proces i dorëzimit dhe miratimit të propozimit për kërkim	11
2. Struktura dhe përmbajtja e propozimit për kërkim	12
<b>IV. ZBATIMI I KËRKIMIT PËR PHD</b>	<b>16</b>
1. Mentorimi	16
2. Vlerësimi i disertacionit të doktoratës	18
<b>V. SIGURIMI I CILËSISË SË STUDIMEVE TË DOKTORATËS</b>	<b>21</b>
<b>SHTOJCAA: RREGULLORJA E UNIVERSITETIT PËR STUDIMET E DOKTORATËS</b>	<b>22</b>
<b>RREGULLORE PËR STUDIMET E DOKTORATËS</b>	<b>22</b>
<b>FORMULARËT E APLIKUESHËM</b>	<b>44</b>
F1 - PARAQITJA E TEMËS SË PUNIMIT TË DOKTORATËS	44
F2 - VLERËSIMI I TEMËS SË DOKTORATËS	49
F3 - VENDIMI I APROVIMIT TË TEMËS SË PUNIMIT TË DOKTORATËS	53
F4 - RAPORTI VJETOR I PROGRESIT TË DOKTORANTIT	56
F5 - DR.SC.-05 RAPORTI VJETOR I MENTORIT PËR PËRPARIMIN E DOKTORANTIT	62
F6 - KËRKESA PËR NDËRRIM TË TEMËS DHE/OSE MENTORIT/BASHKËMENTORIT	65
F7 - KËRKESË PËR SHTYRJE TË MBROJTJES PUBLIKE TË PUNIMIT TË DOKTORATËS	68
F8 - UDHËZIMET PËR PËRPILIMIN E PUNIMIT TË DOKTORATËS	70
F9 - RAPORTI VJETOR MBI PROGRAMIN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS	76
F10 - RAPORTI MBI VLERËSIMIN E PUNIMIT / DORËSHKRIMIT TË DOKTORATËS	82
F11 - PROTOKOLLI DHE PROCESVERBALI PËR MBROJTJEN E PUNIMIT TË DOKTORATËS	85

## I. HYRJJE

Ky doracak është menduar si një paketë e udhëzimeve për zbatimin e programit të doktoratës “PhD në arsimimin e mësimdhënësve dhe në shkencat e edukimit”, që ofrohet nga Universiteti i Prishtinës i akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës. Ky doracak është shkruar si një përmbledhje e proceseve, procedurave dhe standardeve për studimet e doktoratës në Fakultetin e Edukimit, me qëllim të mbështetjes së stafit akademik të Fakultetit të Edukimit të përfshirë në zbatimin e studimeve të doktoratës, si dhe strukturave menaxhuese të përfshira në zbatimin e studimeve të doktoratës, gjegjësisht me qëllim të mbështetjes së menaxhmentit të Fakultetit të Edukimit dhe Këshillit të Studimeve të Doktoratës në Fakultetin e Edukimit. Për më tepër dhe më e rëndësishmja, ky doracak do t'i ndihmojë studentëve të PhD-së që të përparojnë në përfundimin e studimeve të doktoratës dhe t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e parapara.

Ky program është programi i parë i PhD-së në këtë fushë në Kosovë dhe si i tillë ka për qëllim që t'i shërbejë një spektri të gjerë të institucioneve dhe profesionistëve në Kosovë. Themelimi i i institucioneve të reja të arsimit të mësimdhënësve (Fakultetet e Edukimit) në sistemin publik të arsimit të lartë në vitet e fundit si dhe synimet për ta avancuar zhvillimin e profesionalizmit të mësimdhënësve në sistemin shkollor, janë dy çështjet kryesore të cilat qëndrojnë prapa arsimit për zhvillimin e këtij programi PhD. Synimet e përgjithshme të këtij programi PhD mund të përmbledhen si më poshtë:

- zhvillimi i ekspertëve të arsimit që do ta mbështesin zhvillimin e sistemit arsimor dhe sistemin shkollor,
- zhvillimi i kuadrit për Fakultetet e Edukimit që i zotërojnë aftësitë dhe konceptet e zhvillimit modern të arsimit,
- zhvillimi i kërkuesve arsimorë të cilët do të jenë në gjendje që të nxisin ide të reja në fushën e shkencave të arsimit.

Duke e pasur parasysh natyrën e studimeve të doktoratës dhe tendencat e përgjithshme në përcaktimin e rezultateve të të nxëniet për programet PhD (shih referencat e përshkruarve të Dublinit dhe

Projektin TUNING), ky program i PhD-së do t'i kontribuojë arritjes së rezultateve specifike si në vijim:

- Thellimi i kuptimit nga kandidatët në lidhje me konceptet teorike dhe metodologjike në fushën e arsimit dhe të shkencave të edukimit.
- Përgatitja e kandidatëve për t'i drejtuar në mënyrë të pavarur projektet kërkimore dhe profesionale shkencore dhe për t'i zotëruar aftësitë e nevojshme për zbatimin e këtyre projekteve.
- Pajisja e kandidatëve me aftësi për të zhvilluar njohuri të reja të pavarura për zgjidhjen e problemeve më të vështira profesionale dhe shkencore përmes një qasjeje ndërdisiplinore.
- Zhvillimi i reflektimit kritik dhe i përgjegjësisë etike të kandidatëve në kërkim dhe kompetencave sociale dhe të komunikimit për udhëheqje profesionale dhe për kërkim.
- Përgatitja e kandidatëve për t'i analizuar në mënyrë kritike faktorët e njohur dhe për të ofruar zgjidhje të reja për probleme specifike dhe praktike.

## ***Korniza e programit të doktoratës***

Programi i PhD-së përbëhet nga komponenta e mësimdhënies dhe komponenti i kërkimeve. Parimet e përgjithshme dhe dispozitat e Rregullores qendrore të universitetit për studimet PhD ofrojnë korniza të përgjithshme, ndërsa i mbetet departamenteve përkatëse që të vendosin se cilët komponentë të mësimdhënies mund t'i mbështesin më së miri studentët në arritjen e rezultateve të dëshiruara. Përmbajtja e propozuar e këtij programi të PhD-së është planifikuar me synim që t'i shërbejë një spektri të gjerë të fushave kërkimore, të cilat mund të adresohen nga studentët në këtë program. Programi përmban një sërë modulesh obligative që të gjithë studentët duhet t'i vijojnë, duke i përfshirë tre seminare kërkimi si dhe module orientimi (2 module) që kanë për qëllim që t'i ekspozojnë studentët në shqyrtim më të thellë të fushës kërkimore që u intereson atyre. Përveç kësaj, secili student duhet t'i vijojë tre module zgjedhore nga një grup i propozuar modulesh, që janë integruar në program.

*Doracak për Studimet e Doktoratës*

	Viti I Semestri I	L (Orë)	S (Orë)	Studim individual	Totali (Orë)	ECTS
1	Teoritë moderne në fushën e shkencave të edukimit O	10	15	125	150	5
2	Metodat e avancuara kërkimore në arsim O	10	15	125	150	5
3	Seminari i doktoratës O		30	120	150	5
4	Moduli i studimit të orientimit O	10	15	125	150	5
5	Moduli i shkrimit të disertacionit	10	15	125	150	5
6	Moduli i kërkimit individual O			150	150	5
	Gjithsej	40	90	790	900	30

	Viti I Semestri II	L (Orë)	S (Orë)	Studim individual	Totali (Orë)	ECTS
1	Trendet bashkëkohore në kërkimet arsimore O	10	15	125	150	5
2	Seminari II i doktoratës O	0	30	120	150	5
3	Moduli II i studimit të orientimit O	10	15	125	150	5
4	Modul zgjedhor	10	15	125	150	5
5	Modul zgjedhor	10	15	125	150	5
6	Moduli i kërkimit individual			150	150	5
	Totali	40	90	790	900	30

	Viti II Semestri III	L (Orë)	S (Orë)	Studim individual	Totali (Orë)	ECTS
	Seminari III i doktoratës O					
2	Modul zgjedhor	10	15	125	150	5
3	Moduli i kërkimit individual			600	600	20
	Totali	20	30	750	900	30

	Viti II Semestri IV	L (Orë)	S (Orë)	Studim individual	Totali (orë)	ECTS
1	Moduli i kërkimit individual			900	900	30
	Totali			900	900	30

	Viti III Semestri V	L (Orë)	S (Orë)	Studim individual	Totali (Orë)	ECTS
1	Moduli i kërkimit individual			900	900	30
	<b>Totali</b>			900	900	30

	Viti III Semestri VI	L (Orë)	S (Orë)	Studim individual	Totali (Orë)	ECTS
1	Moduli i kërkimit individual		30	870	900	30
	<b>Totali</b>			900	900	30

### **Modulet e studimit të orientimit (kandidatët i zgjedhin 2 module):**

<b>Modulet (5 ECTS secili)</b>
1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia I dhe II
2. Mësimdhënia e shkencave natyrore I dhe II
3. Mësimdhënia e matematikës I dhe II
4. Mësimdhënia e shkencave shoqërore I dhe II
5. Arsimi përfshirës I dhe II
6. Edukimi parashkollor I dhe II
7. Udhëheqja arsimore I dhe II

### **Modulet zgjedhore1- (kandidatët i zgjedhin 3 module: 3x5 ECTS)**

<b>Modulet</b>
1. Kërkimi cilësor
2. Kërkimi sasior
3. Shkrimi i artikujve shkencorë dhe prezantimi i rezultateve
4. Kurs i avancuar për arsimin e personave me nevojave të veçanta
5. Kurs i avancuar për komunikimin në arsim
6. Psikologjia e stresit
7. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

<sup>1</sup> Modulet zgjedhore synojnë forcimin e kompetencave të përgjithshme relevante, transferimin e njohurive dhe kompetencave nga lënda në një kuptim më të gjerë dhe nga një perspektivë ndër-disiplinore.

8. Kurs i avancuar për vlerësimin e arsimit
9. Arsimimi ndërkombëtar
10. Politikat arsimore
11. Këshillimi individual dhe organizativ
12. Mësimdhënia dhe mësimnxënia në arsimin e lartë

### ***Kriteret për përfundimin e programit të studimeve të doktoratës***

Kriteret për përfundimin e programit të studimeve të doktoratës janë përcaktuar në Rregulloren e universitetit për studimet PhD, si dhe specifikimet e përcaktuara në programin e akredituar nga autoriteti kombëtar i akreditimit.

Studimet e doktoratës organizohen në gjashtë semestra:

1. Në semestrin e parë, studenti i akumulon 30 ECTS nga përfundimi i kurseve/moduleve dhe seminareve të studimeve të doktoratës siç është paraparë në programin e akredituar.
2. Në semestrin e dytë, studenti i akumulon 30 ECTS nga kurset/modulet dhe seminarët siç është paraparë në programin e akredituar.
3. Në semestrin e tretë, studenti i mbledh 30 ECTS pas përfundimit të një seminari kërkimor dhe vlerësimit pozitiv të miratimit të propozim-projektit të doktoratës nga Këshilli qendror për PhD i njësisë akademike dhe nga Këshilli qendror i studimeve të doktoratës, si dhe miratimi final i projektpropozimit dhe mentorit nga ana e Senatit të Universitetit.
4. Në tre semestrat e mbetur, studenti i akumulon 90 ECTS përmes:
  - Botimi i një artikulli që lidhet me punën e disertacionit të doktoratës, duke e përfshirë mundësinë e përdorimit të një pjese të të dhënave të grumbulluara për disertacionin e doktoratës në një revistë ndërkombëtare me recenzion të fshehtë dhe indeksim cilësor (bazuar në rregulloret e aplikueshme të Universitetit për standardet e revistave që përdoren për qëllime të avancimit të stafit akademik (20 ECTS).
  - Të paktën dy prezantime në takime shkencore (konferenca, kongrese, etj.), prej të cilave një të jetë me karakter ndërkombëtar



(10 ECTS).

- Përfundimi dhe mbrojtja publike e tezës së doktoratës (60 ECTS).

## **II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E STUDIMEVE TË DOKTORATËS**

Struktura kryesore që përfshihet në zbatimin e studimeve të doktoratës është menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit (dekanati, këshilli i studimeve të doktoratës dhe zyra/shërbimi për studentët e doktoratës). Secili prej tyre luan një rol vendimtar, ku koordinimi i përpjekjeve dhe koherenca e veprimeve të tyre është kritike për zbatimin e programit të studimeve të doktoratës.

### **1. Përgjegjësitë e Dekanatit**

Menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit është përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme në zbatimin e programit të studimeve të doktoratës:

- Caktimin e ligjëratave dhe seminareve të studimeve të doktoratës.
- Caktimin i ligjëruesve të kursit/modulit dhe udhëheqësve dhe kontribuesve të seminareve kërkimore.
- Menaxhimin e procesit të kontraktimit të stafit të përfshirë në ligjërime dhe mentorim në programin e doktoratës.
- Sigurimin i burimeve të nevojshme për zbatimin e programit të studimeve të doktoratës.
- Lehtësimin e komunikimit në mes të Këshillit të studimeve të doktoratës në nivelin e Fakultetit dhe Këshillit të Fakultetit, në njërin anë dhe Këshillit të Fakultetit dhe të Këshillit qendror të studimeve të doktoratës, nga ana tjetër.
- Sigurimin i kushteve të nevojshme të punës për Këshillin e studimeve të doktoratës dhe stafin e përfshirë në zbatim.

### **2. Këshilli i studimeve të doktoratës**

Sipas Rregullores për studimet e doktoratës në nivel të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i studimeve të doktoratës i Fakultetit të Edukimit

është përgjegjës për zbatimin e Programit të Doktoratës. Më konkretisht, Këshilli i studimeve të doktoratës në Fakultetin e Edukimit është përgjegjës për këto aktivitete:

- Menaxhon procesin e projekt propozimeve për temë të doktoratës duke përfshirë elaborimin e udhëzimeve shtesë për studentët.
- Menaxhon procesin e sigurimit të cilësisë së studimeve të doktoratës.
- Shqyrton propozimet për kërkime të doktoratës dhe mentorët e propozuar dhe i rekomandon Këshillit të Fakultetit anëtarët e Komisionit, të cilët e vlerësojnë propozimin e kërkimit.
- Shqyrton raportin e vlerësimit të Komisionit shqyrtues rreth propozimit të kërkimit për doktoratë dhe i propozon Këshillit të Fakultetit miratimin e propozimit ose ndryshimet që kandidati duhet t'i bëjë.
- I propozon Këshillit të Fakultetit themelimin e Komisionit të mbrojtjes së disertacionit të doktoratës.
- Shqyrton raportin nga Komisioni i mbrojtjes së disertacionit të doktoratës dhe i rekomandon Këshillit të Fakultetit miratimin e mbrojtjes kur konsiderohet se janë plotësuar standardet e cilësisë.
- Shqyrton programin e doktoratës periodikisht me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe ri-akreditimit të programit.

### **3. Shërbimi/zyra për studimet e doktoratës**

Menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit e cakton zyrën dhe zyrtarët përgjegjës për ofrimin e mbështetjes teknike dhe logjistike për zbatimin e studimeve të doktoratës. Shërbimi është gjithashtu përgjegjës për protokollin dhe mbështetjen logjistike për punën e Komisionit të studimeve të doktoratës. Zyra e studimeve të doktoratës është e vendosur në Fakultetin e Edukimit, kati 3. Të gjitha e-mailat që vijnë nga studentët e doktoratës, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me programin e studimeve të doktoratës, duhet të dërgohen tek zyrtarja e studimeve të doktoratës, duke vendosur në CC (kopje) prodekanët dhe udhëheqësin e Këshillit të studimeve të doktoratës, sipas nevojës në bazë të roleve dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë doracak.

### **III. SHKRIMI DHE MIRATIMI I PROPOZIMEVE PËR KËRKIME**

#### ***1. Procesi i dorëzimit dhe miratimit të propozimit për kërkim***

Sipas Rregullores së universitetit për studimet e doktoratës, procesi i paraqitjes dhe i miratimit të propozimit për kërkim duhet të zhvillohet në këtë mënyrë:

- Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës, kandidati për PhD finalizon projektin e hulumtimit bashk me mentorin dhe propozon atë dhe mentorin në semestrin e tretë.
- Kandidati i doktoratës e fillon procedurën për dorëzimin e propozimit për kërkim të doktoratës përmes aplikacionit, i cili përbëhet nga formulari që është mandatar nga Këshilli qendror i studimeve të doktoratës. Studenti mund ta shtjellojë një propozim më të përpunuar kërkimor për Këshillin e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Edukimit për ta mundësuar një proces më të plotë të shqyrtimit. Ky propozim më i përpunuar i kërkimit nuk kufizohet në numrin e faqeve, por nuk duhet t'i kalojë 10 faqe dhe mund t'i bashkëngjitet formularit të aplikimit (F1) të mandatar përmes Rregullores qendrore për studimet e doktoratës. Aplikacioni dorëzohet pranë Zyrës për Master dhe Doktoratë dhe kërkesa regjistrohet në protokoll përpara se t'i dorëzohet Këshillit të studimeve të doktoratës.
- Këshilli i Fakultetit, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës të Fakultetit të Edukimit, e emëron një komision prej tre ose pesë anëtarëve për ta vlerësuar propozimin për kërkim, mentorin dhe bashkë-mentorin e propozuar. Të paktën një anëtar i Komisionit duhet të jetë i jashtëm nga Fakulteti i Edukimit ose jashtë Kosovës dhe dikush që nuk ka qenë i përfshirë në mësimdhënie në programin e njëjtë të doktoratës. Mentori i propozuar nuk mund të jetë anëtar i këtij Komisioni.
- Komisioni për vlerësimin e propozimit të kërkimit e vlerëson

propozimin e kërkimit në bazë të standardeve të përkruara në këtë doracak dhe e dorëzon raportin e vlerësimit pranë Këshillit të studimeve të doktoratës në Fakultet.

- Këshilli i studimeve të doktoratës duhet ta shqyrtojë raportin e vlerësimit të komisionit të vlerësimit në semestrin e tretë, ose kur studenti të jetë gati që ta paraqesë propozimin.
- Kandidati duhet ta paraqesë/mbrojë propozimin para Këshillit të studimeve të doktoratës, komisionit të vlerësimit dhe mentorit e bashkë-mentorit të propozuar (nëse kërkohet), 30 ditë pas dorëzimit të raportit të komisionit të vlerësimit.
- Pas mbrojtjes, Këshilli i studimeve të doktoratës e përcjell propozimin për miratim në Këshillin e Fakultetit, i cili pastaj e proceson kërkesën drejt Këshillit qendror të Universitetit për studimet e doktoratës dhe Senatit. Kërkesa procesohet përmes menaxhmentit të Fakultetit të Edukimit.
- Rrjedha e procesit dokumentohet dhe formalisht regjistrohet në procesverbal, e njëjta gjë bëhet edhe për vendimet formale të Këshillit të Fakultetit përmes së cilave është miratuar propozimi për kërkim.
- Të gjitha propozimet për kërkime duhet ta përfshijnë dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar se propozimet e kërkimit i respektojnë dispozitat e aplikueshme të rregullave të etikës kërkimore të zbatueshme në nivel universiteti, veçanërisht në lidhje me përfshirjen e subjekteve relevante në kërkim.

## **2. Struktura dhe përmbajtja e propozimit për kërkim**

Propozimi për kërkim duhet të jetë jo më i gjatë se 10 faqe, duke përfshirë listën e referencave. Studentët duhet ta përdorin stilin e referimit APA, *times new roman*, një hapsirë (*single line spacing*). Ky propozim i elaboruar për kërkim përbën bazën për plotësimin e formularit formal të aplikimit (F1 në Rregulloren qendrore për studimet e doktoratës). Propozimi për kërkim duhet ta përfshijë informacionin e mëposhtëm:

## **Titulli i propozimit për kërkim**

Nuk duhet të jetë më i gjatë se 20 fjalë dhe nuk duhet të ketë akronime dhe shenja pikësimi. Ai duhet të tregojë qartë se çfarë do të përfshihet në kërkim dhe nuk duhet të jetë abstrakt e i paqartë. Titulli nuk mund të ndryshohet pasi të jetë miratuar.

## **Fjalët kyçe**

Duhet të përcaktohet një listë prej tre deri në pesë fjalë kyçe të renditura në mënyrë alfabetike. Këto fjalë duhet të jenë të lidhura qartë me temën e propozuar të kërkimit.

## **Abstrakti**

Abstrakti duhet të jetë një përmbledhje prej 300 fjalësh që e tregon problemin që po studionet dhe qëllimin e këtij kërkimi. Përveç kësaj, abstrakti e përshkruan kornizën teorike që përdoret për ta realizuar këtë studim, si dhe përcaktohen zgjedhjet metodologjike që do të bëhen për zbatimin e këtij kërkimi. Abstrakti përfundon me një deklaratë të rezultateve të pritshme të kërkimit dhe kontributin shkencor që pritet ta japë kërkimi i propozuar.

## **Arsyetimi dhe qëllimi**

Në këtë seksion, kandidati i adreson çështjet e mëposhtme:

- Rëndësia e projektit në lidhje me njohuritë/literaturën aktuale: Si lidhet projekti me kërkimet e mëparshme ndërkombëtare dhe kombëtare? Si do ta avancojë apo ta ripërtërijë ky projekt gjendjen aktuale? Si do të kontribuojë ky kërkim në zhvillimin e njohurive dhe debateve teorike mbi temën përkatëse?
- Si lidhet kërkimi i propozuar me kërkimet e mëparshme të viteve të fundit?

## **Korniza teorike**

Ky seksion duhet ta tregojë qartë kornizën teorike që do ta zbatojë kërkimi i propozuar. Kjo pjesë gjithashtu duhet ta bëjë argumentimin e nevojshëm për zgjedhjet e bëra për konstruktet kryesore, debatet

dhe teoritë e literaturës që hulumtuesi i përdor për realizimin e këtij kërkimi. Është e rëndësishme që kërkimi i propozuar të tregojë lidhje të qarta midis kornizës teorike dhe të dhënave, si dhe pritjeve nga ky kërkim. Propozimi i kërkimit duhet ta tregojë shfrytëzimin e së paku 25 referencave relevante shkencore, të cilat e lidhin ngushtë temën e propozuar të kërkimit me literaturën mbizotëruese të viteve të fundit.

## **Qëllimi dhe pyetjet e kërkimit**

### **a. Objektivat e kërkimit**

- Qartësohen objektivat/qëllimi i projektit kërkimor dhe bazat teorike
- specifikohen pyetjet dhe/ose hipotezat e kërkimit

### **b. Kontributi shkencor, praktik dhe më i gjerë**

- Paraqiten rezultatet e pritura të kërkimit dhe ndikimi i tyre i parashikuar shkencor, potenciali për zbulime të reja shkencore dhe për rinovimin e shkencës e të kërkimit.

Sipas nevojës, kërkimi i doktoratës duhet ta marrë në konsideratë ndikimin përtej akademisë duke përfshirë:

- Shtrirjen dhe vlerën e mundshme të shfrytëzimit të kërkimit përtej komunitetit shkencor, përfshirë këtu rëndësinë praktike të këtij kërkimi.
- Vlerësimin e vet aplikuesit lidhur me potencialin për ndikimin shoqëror në afat të gjatë apo të shkurtër.

## **Metodologjia kërkimore**

Seksioni për metodologjinë kërkimore duhet t'i elaborojë zgjedhjet dhe vendimet metodologjike kryesore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Metodën kërkimore, të përshkruara në mënyrë të tillë që të shpjegohet se pse janë zgjedhur, si do të kontribuojnë në përgjigjen e pyetjeve të kërkimit/për testimin e hipotezave;
- Të dhënat që do të mblidhen në lidhje me pyetjet dhe/ose hipotezën e kërkimit. Në këtë seksion, kandidati duhet t'i

përpunojë instrumentet që do të përdoren për grumbullimin e të dhënave dhe konstruktet kryesore që ata do t'i reflektojnë. Duhet gjithashtu të theksohet se si do të zhvillohet instrumenti (i adaptuar nga diku tjetër ose i zhvilluar nga hulumtuesi dhe si). Kur flasim për instrumentet sasiore, kandidati duhet t'i adresojë karakteristikat matëse të instrumenteve dhe mënyrën se si do të maten.

- Mostrat, procesin dhe kornizën e mostrimit.
- Procesin që do të ndiqet për mbledhjen e të dhënave dhe për analizën e të dhënave, duke përfshirë mënyrën se si do të kryhen analizat cilësore dhe sasiore (llojet e testeve që do të kryhen).

### **Çështjet etike**

Kandidati duhet t'i përpunojë masat që ai do t'i ndërmarrë për t'i respektuar të gjitha standardet etike gjatë procesit të kryerjes së kërkimeve të tyre. Ky seksion i trajton çështjet e pëlqimit të informuar, anonimitetit të subjekteve, dispozitat për tërheqjen nga kërkimi, si dhe standarde të tjera të zbatueshme në lidhje me temën, metodat dhe të dhënat e zgjedhura.

### **Orari i realizimit**

Në këtë seksion, kandidati i përshkruan hapat që duhet të ndërmerren, si dhe kohën kur secili hap duhet të përfundojë. Orari mund të paraqitet edhe në formatin e tabelës.



## IV. ZBATIMI I KËRKIMIT TË DOKTORATËS

Proceset dhe fazat e kryerjes së kërkimit të doktoratës janë përshkruar pikërisht në Rregulloren qendrore të studimeve të doktoratës. Studentët duhet t'i shqyrtojnë me kujdes këta hapa dhe të punojnë me administratën e fakultetit për t'u siguruar se të gjithë hapat e nevojshëm janë plotësuar. Marrëdhëniet ndërmjet mentorit dhe bashkë-mentorit me studentët e doktoratës janë vendimtare për suksesin e studentëve në programin e doktoratës. Prandaj duhet të jetë e qartë se cilat janë pritjet e studentëve dhe veçanërisht të mentorëve dhe bashkë-mentorëve për t'i mbështetur studentët e doktoratës. Nga ana tjetër, duhet të jetë gjithashtu e qartë se kërkimi i doktoratës është punë individuale dhe e pavarur e studentëve, të cilët megjithatë duhet të mbikëqyren dhe të mbështeten në mënyrë adekuate.

Zbatimi i suksesshëm i kërkimit në nivel doktrate është i lidhur ngushtë me cilësinë e bashkëpunimit mes mentorit dhe studentit. Është kritike mbështetja e ofruar për studentin e doktoratës për të siguruar arritjen e standardeve minimale të përcaktuara për kërkim të doktoratës. Më poshtë është një elaborim më i hollësishëm i aranzhimeve të mentorimit dhe përgjegjësive të palëve të përfshira, si dhe standardeve që shërbejnë si udhëzues për vlerësimin e disertacionit të doktoratës në këtë program, që mund t'i udhëheqin studentët, mentorët dhe komisionet e vlerësimit për ta kryer punën e tyre.

### **1. Mentorimi**

Mentorët caktohen në bazë të rregullores së aplikueshme të universitetit për studimet e doktoratës. Studentët mund ta kenë edhe një bashkë-mentor për kërkimin e tyre dhe bashkë-mentori mund të jetë edhe nga jashtë Universitetit të Prishtinës. Bazuar në rregulloret e aplikueshme të universitetit dhe standardet ndërkombëtare, mentorët dhe bashkë-mentorët duhet t'i kenë të paktën tri referenca shkencore me recenzion ndërkombëtar. Përveç kësaj, sfondi i mentorit dhe i bashkë-mentorit duhet të jetë i lidhur me fushën e ngushtë të kërkimit të doktoratës.

## **Përgjegjësitë e mentorit**

Përgjegjësitë e mentorit dhe bashkë-mentorit janë:

- Sigurimi i udhëzimit të nevojshëm të studentëve gjatë procesit të hartimit të propozimit të kërkimit, si dhe kryerjes së kërkimit dhe shkrimit të disertacionit.
- Studentit t'i sigurohet një reagim konstruktiv, kritik dhe në kohë lidhur me kërkimin gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe programit të studimeve të doktoratës;
- Përkrahja e studentëve në mundësitë për t'u angazhuar në forume të ndryshme ku ata mund t'i paraqesin kërkimet e tyre dhe të marrin reagime, duke përfshirë këtu edhe konferencat shkencore.
- Përkrahja e studentëve në botimin e artikujve në revista relevante si pjesë e përbushjes së kërkesave të programit të PhD-së.
- Sigurimi se disertacioni i doktoratës i respekton parimet e integritetit akademik dhe e shmang çdo praktikë plagjiature.
- Sigurimi i një raporti vjetor mbi ecurinë e studentit të doktoratës dhe sfidat që duhen adresuar.

## **Përgjegjësitë e studentëve të doktoratës**

Studentët e doktoratës duhet të kuptojnë se përparimi drejt plotësimit të kërkesave të tyre për shkallën e doktoratës është përgjegjësi e tyre individuale. Studentët e doktoratës janë përgjegjës:

- Për të mbajtur kontakt të vazhdueshëm me mentorin (dhe bashkë-mentorin) dhe të kërkojnë miratimin për çdo hap në kërkimit të doktoratës.
- Për të vepruar sipas këshillave të mentorëve në lidhje me studimet në përgjithësi dhe kërkimet në veçanti.
- Për pjesëmarrje në konferencat relevante kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat ata mund t'i paraqesin kërkimet e tyre.
- Për të qenë proaktivë në përbushjen e kërkesave të programit, duke përfshirë botimin e një artikulli me recension dhe prezantimin në konferenca ndërkombëtare.
- Për sigurimin e një raporti vjetor të përparimit të kërkimit dhe përfundimit të programit për këshillin e studimeve të doktoratës, siç është përcaktuar në Rregulloren qendrore të studimeve të doktoratës.

## 2. Vlerësimi i disertacionit të doktoratës

Procesi dhe fazat e vlerësimit janë elaboruar në Rregulloren e studimeve të doktoratës. Kriteret dhe udhëzimet e mëposhtme janë paraqitur si udhëzues për studentët, mentorët dhe komisionin e vlerësimit për t'i marrë si pika referimi në rolet e tyre. Komisionet e vlerësimit duhet t'i përmbahen standardeve të përgjithshme akademike të kryerjes së kërkimit të mirë dhe vlerësimit të disertacionit specifik kundrejt kriterëve. Anëtarët e komisionit duhet të diskutojnë dhe ta formojnë një opinion mbi vlerësimin për një disertacion të veçantë, por në rastet kur opinioni i një anëtarë ndryshon nga ai i anëtarëve tjerë të komisionit në mënyrë substanciale është e mundur që ky anëtar të vendosë që ta shkruajë një vlerësim të veçantë. Komisioni duhet të bëjë edhe komente duke ofruar komente narrative dhe argumente për disertacionin përkatës. Kriteret për vlerësim janë: 100 - 80 pikë të mundshme = “shumë mirë”, 79 - 65 pikë të mundshme = “mirë”; 64 - 50 pikë të mundshme = “kënaqshëm”; 49 dhe më pak pika të mundshme = “dështim”). Formulari i mëposhtëm përdoret nga anëtarët e komisionit të vlerësimit si mjet për paraqitjen e vlerësimit të tyre individual, që i shërben nevojave të plotësimit të raportit/formularit përfundimtar të Rregullores së studimeve të doktoratës (F10).

Kriteret	Vlerësimi			
	Shumë i mirë	I mirë	Kënaqshëm	Dështim
<p><i>Zgjedhja e temave dhe e problemeve kërkimore</i></p> <p>Ndërsa tema e disertacionit duhet të jetë e lidhur me kërkimet e mëparshme, disertacioni duhet gjithashtu të gjenerojë njohuri të reja. Mund të shërbejë edhe për ta hapur një linjë të re të kërkimit. Studimi duhet të definohet në mënyrë të qartë. Pyetjet e kërkimit duhet të formulohen në atë mënyrë që të jetë e mundur të ofrohen përgjigje në mënyrë të arsyeshme brenda fushëveprimit të studimit.</p>				

<p><i>Qartësia konceptuale dhe zotërimi teorik i temës</i> Konceptet duhet të jenë të qarta dhe autori duhet të demonstrojë se i zotëron teoritë që qëndrojnë prapa kërkimit dhe është në gjendje që ta konceptojë problemin e kërkimit.</p>				
<p><i>Shfrytëzimi i metodave</i> Metodatat duhet të jenë të bazuara mirë dhe t'i mundësojnë autorit që ta adresojë problemin e kërkimit. Shfrytëzimi i metodave të kërkimit duhet të jetë adekuat. Zgjedhja e metodave duhet të argumentohet dhe të dokumentohet mirë.</p>				
<p><i>Paraqitja e rezultateve</i> Rezultatet duhet të paraqiten në mënyrë të qartë dhe logjike. Analiza duhet të jetë logjike dhe e bazuar mirë. Autori duhet të përpiqet që të sigurojë se prezantimi i rezultateve të jetë i qëllimshëm dhe koherent, duke u përpjekur që ta gjejë mënyrën më efikase dhe më të sofistikuar për prezantimin e rezultateve përkatëse.</p>				
<p><i>Konkluzionet</i> Konkluzionet duhet të jenë sistematike dhe të bazuara mirë në lidhje me problemin e kërkimit, të dhënat dhe metodat e përdorura. Autori duhet t'i shmangë spekulimet dhe paragjykimet personale, ndërsa duhet të provohen lidhjet e qarta me të dhënat dhe literaturën. Konkluzionet duhet ta tregojnë kontributin shkencor të kërkimit.</p>				

<p><i>Disertacioni</i> si tërësi dhe standardi i gjuhës së përdorur Disertacioni duhet ta ketë një strukturë logjike me gjuhë të qartë. Teksti duhet të jetë koherent dhe logjik dhe të përqendrohet në gjërat thelbësore. Argumentimi duhet të rrjedhë në mënyrë logjike. Kërkuesi duhet të demonstrojë mendim kritik, origjinalitet dhe pavarësi.</p>				
---	--	--	--	--

### **Komentet për draftin e disertacionit**

Komentet dhe sqarimet lidhur me vlerësimin e mësipërm:

Nënshkrimi:

Data:

## **V. SIGURIMI I CILËSISË SË STUDIMEVE TË DOKTORATËS**

Shërbimi i studimeve të doktoratës është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave dhe informatave për çdo student doktorate dhe për çdo grup, duke përfshirë procesin e pranimit dhe përparimin në të gjithë programin. Këshilli i studimeve të doktoratës e menaxhon procesin e vlerësimit të studimeve të doktoratës në baza vjetore, në këtë mënyrë e formon bazën për vetëvlerësim për qëllime riakreditimi.

Vetëvlerësimi bëhet në bazë të parametrave të mëposhtëm: cilësia e ligjëratave, cilësia e progresit në kërkim, cilësia e mentorimit dhe përkrahjes, cilësia e qasjes në literaturë, cilësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në studimet e doktoratës, cilësia e përkrahjes nga administrata, etj.

Këshilli i studimeve të doktoratës i shfrytëzon instrumentet ekzistuese në Rregulloren qendrore të universitetit për studimet e doktoratës, si dhe i zhvillon instrumentet shtesë për grumbullimin e të dhënave, si dhe standardet dhe formatin e hartimit të raportit. Shqyrtimi i cilësisë do të bazohet kryesisht në raportin vjetor të studentëve të doktoratës dhe mentorëve e bashkë-mentorëve. Mbledhja e të dhënave shtesë të fokusuara të shqyrtimit të cilësisë do të menaxhohet në baza periodike, si dhe për nevojat e riakreditimit të programit. Këshilli i studimeve të doktoratës është gjithashtu përgjegjës për hartimin e raportit vjetor të cilësisë. Raporti i dorëzohet Menaxhmentit të Fakultetit dhe Këshillit të Fakultetit.

# SHTOJCAA: RREGULLORJA E UNIVERSITETIT PËR STUDIMET E DOKTORATËS

## RREGULLORE PËR STUDIMET E DOKTORATËS

### *Dispozitat e përgjithshme*

#### **Neni 1**

- (1) Me Rregulloren për studime të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (në vazhdim: Rregullorja) rregullohet organizimi dhe realizimi i studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës (në vazhdim: Universiteti), institucioni përgjegjës për organizimin e studimeve (në vazhdim: institucioni përgjegjës i studimeve), format dhe kohëzgjatja e studimeve, kriteret për regjistrimin në studime, mënyra e realizimit të studimeve, mësimi dhe hulumtimi, procedura e paraqitjes, e vlerësimit dhe e mbrojtjes së punimit të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e studentit në studime të doktoratës (në vazhdim: doktoranti), të drejtat dhe obligimet e mentorit, mënyrat e sigurimit të cilësisë, si dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës.
- (2) Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret e domosdoshme për aktivitetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 2**

Kuptimi i nocioneve sipas kësaj Rregulloreje:

- (1) Këshilli i studimeve të doktoratës, në nivel të njësisë akademike (fakultetit), është këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, ndërsa në nivel të Universitetit është Këshilli qendror i studimeve të doktoratës.
  1. Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike

përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë nga radhët e profesorëve nga secili departament i njësisë akademike. Mbledhja e parë (konstituive) ftohet dhe udhëhiqet nga dekani i njësisë akademike. Pas konstituimit të këshillit të studimeve të doktoratës, ai nga radhët e veta e zgjedh kryetarin.

2. Këshilli qendror i studimeve të doktoratës ka këtë përbërje:
  - Rektori;
  - Prorektori për kërkime shkencore;
  - Prorektori për mësim;
  - Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave shoqërore;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave humanistike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave teknike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i arteve;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave matematike-natyrore;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i mjekësisë;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave të bujqësisë dhe veterinës;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave juridike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i shkencave ekonomike;
  - Një profesor i rregullt ose një profesor i asocuar nga lëmi i edukimit fizik dhe sportit;
  - Drejtori i Zyrës për Zhvillim Akademik (ZZHA) – pa të drejtë vote.
3. Anëtarët e Këshillit qendror të studimeve të doktoratës i



propozon rektori dhe i zgjedh Senati.

4. Këshilli qendror i studimeve të doktoratës kryesohet nga rektori. Në mungesë të tij/saj, Këshilli kryesohet nga prorektori për kërkime shkencore. Në rastin e votave të barabarta, vota e kryesuesit është përcaktuese.
- (3) Institucioni përgjegjës i studimeve është një ose më shumë njësi akademike, një ose më shumë universitete brenda dhe jashtë vendit, të cilat i organizojnë dhe i realizojnë studimet e doktoratës, dhe të cilat e përfundojnë procedurën e arritjes së doktoratës shkencore/artistike.
- (4) Udhëheqësi i programit të studimeve të doktoratës është i punësuar me titull shkencor-mësimor, artistik-mësimor ose me titull shkencor në njësinë akademike në të cilën zhvillohen studimet.
- (5) Mentori është personi i emëruar me titull shkencor-mësimor ose artistik-mësimor, i cili e udhëheq doktorantin gjatë punimit të disertacionit të doktoratës.
- (6) Dosja e doktorantit është dosja e cila i përmban të gjitha shënimet qenësore të doktorantit prej momentit të pranimit të tij e deri te promovimi. Njësia akademike përkatëse është përgjegjëse për mbledhjen dhe për ruajtjen e të dhënave në dosje.

### Neni 3

- (1) Studime të doktoratës ofrojnë njësitë akademike (*fakultetet*) dhe/ose universiteti/universitetet në një a më shumë lëmenj shkencorë, nëse kanë kontratë të nënshkruar për marrëdhënie pune me orar të plotë, me më së paku gjysmën e numrit të arsimtarëve të angazhuar në atë program studimi.
- (2) Studimet e doktoratës mund të themelohen dhe të realizohen vetëm në ata lëmenj shkencorë në të cilët institucioni përgjegjës ka arritje të pranuar ndërkombëtare në kërkimet shkencore ose artistike, përkatësisht në krijimtarinë artistike, e që konfirmohet me akreditimin e tyre nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA).

- (3) Me studimet e doktoratës udhëheq këshilli i studimeve të doktoratës (në vazhdim: Këshilli i studimeve të doktoratës në njësinë përkatëse akademike).
- (4) Karakteristikat themelore të studimeve të doktoratës në Universitet janë hulumtimi dhe të mësuarit nëpërmjet hulumtimit, ndërkombëtarizimi, transparenca, vlerësimi ndërkombëtar i cilësisë dhe konkurrenca ndërkombëtare.
- (5) Me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe nxitjes së lëvizshmërisë/mobilitetit të doktorantëve dhe të stafit akademik, studimet e doktoratës janë të hapura për çdo formë të bashkëpunimit me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

### ***Qëllimet e studimeve të doktoratës***

#### **Neni 4**

Qëllimet e studimeve të doktoratës janë:

1. Krijimi i diturive, i njohurive dhe i praktikave artistike të reja dhe relevante, si dhe zbatimi i tyre;
2. Arsimitimi i hulumtuesve dhe i studiuesve të dalluar në fusha të caktuara shkencore ose artistike;
3. Aftësimi i doktorantëve për punë të pavarur kërkimore/artistike, për hulumtime të pavarura dhe për vlerësime kritike të punës së të tjerëve.
4. Arritja e diturive, përvojave dhe shkathtësive, të cilat duhet t'u mundësojnë doktorëve të shkencave që, në mënyrë kreative dhe të mbështetur në hulumtime, të ofrojnë kontribut origjinal dhe domethënës në fushat përkatëse të dijes;
5. Ndërkombëtarizimi i punës kërkimore/artistike në Universitet.

## **Mësimi dhe hulumtimi në studimet e doktoratës**

### **Neni 5**

- (1) Komponenti thelbësor i studimeve universitare të doktoratës është kërkimi dhe krijimi shkencor/artistik.
- (2) Format e punës në studimet e doktoratës janë seminarët kërkimore, puna eksperimentale, punëtoritë dhe grupet e diskutimit, me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore, mendimit kritik, përvetësimit të metodologjisë dhe shkathtësive të përgjithshme.
- (3) Mësimi në formë të ligjëratave nuk mund të kalojë 20 përqindëshin e ngarkesës së përgjithshme të paraparë me programin e studimeve dhe të llogaritur sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS).
- (4) Sipas mundësive dhe në bazë të kushteve të përcaktuara paraprakisht, ndjekja e mësimëve në studimet e doktoratës është e hapur për të gjithë doktorantët e Universitetit. Disa pjesë të kërkimeve dhe të mësimit në studimet e doktoratës mund të ndiqen edhe nga doktorantët e universiteteve të tjera, sipas kushteve të parapara në kontratën paraprakisht të nënshkruar ndërmjet universiteteve në fjalë.
- (5) Me qëllim të arritjes së interdisiplinaritetit dhe në bazë të arsyetimit dhe pëlqimit të mentorit, si dhe të pëlqimit të këshillit të studimeve të doktoratës, doktorantët mund të kryejnë pjesë të caktuara të kërkimit dhe të krijimtarisë artistike edhe në njësitë e tjera akademike të Universitetit ose në institucione të tjera përkatëse brenda dhe jashtë vendit.
- (6) Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'u caktojë doktorantëve lëndë plotësuese për arritjen e diturive themelore, të domosdoshme për vijimin dhe përfundimin e studimeve.

## **Format e studimeve të doktoratës**

### **Neni 6**

- (1) Studimet e doktoratës mund të organizohen në njërin prej këtyre formave:
1. Studimet e doktoratës për të cilat institucion përgjegjës është vetëm një njësi akademike ose Universiteti;
  2. Doktorata e dyfishtë, në të cilin doktoranti i merr dy diploma dhe për të cilën është i obliguar edhe mentorimi i dyfishtë;
  3. Studimet e përbashkëta të cilat i realizojnë dy a më shumë universitete, por vetëm një universitet është institucion përgjegjës;
  4. Modeli në të cilin doktoranti i regjistron studimet në një universitet dhe merr diplomën e institucionit përgjegjës të studimeve, ndërsa kërkimet i kryen në më shumë institucione dhe mund të ketë më shumë mentorë;
  5. Studimet e përbashkëta janë program i akredituar i dy ose më shumë universiteteve. Secili universitet merr pjesë në regjistrimin e doktorantëve, ndërsa doktoranti mund të fitojë diplomë të vetme të dy ose më shumë universiteteve, ose diplomën e universitetit në të cilin i ka regjistruar studimet e doktoratës, e në të cilën shkruan se studimet kanë qenë të përbashkëta.
- (2) Nuk lejohet transferimi i studimeve të doktoratës nga një njësi akademike në tjetrën brenda Universitetit të Prishtinës, e as nga universitetet e tjera në Universitetin e Prishtinës. Studentët pranohen vetëm në bazë të konkurrimit në konkursin e shpallur.

## ***Kushtet e regjistrimit dhe kohëzgjatja e studimeve***

### **Neni 7**

- (1) Kushtet e regjistrimit i përcakton Senati i Universitetit, me

propozimin e KQSD-së dhe në pajtim me këtë Rregullore.

(2) Konkursi publik për regjistrim në studime të doktoratës shpallet më së paku një muaj para fillimit të vitit akademik. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë:

1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të deklaratës së Bolonjës – niveli i studimeve master shkencor;
3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 kredite European Credit Transfer System (ECTS);
4. Kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake veç e veç;
5. Kandidatët të cilët e kanë dëshminë për njohjen e një gjuhe të huaj botërore (anglisht, gjermanisht, frëngjisht ose gjuhë tjetër botërore) nga institucioni i autorizuar (fakulteti përkatës ose institucionet e akredituara).

(3) Kriteret e vlerësimit të kandidatëve përfshijnë: suksesin në shkollim gjatë studimeve, interesin e treguar për kërkime shkencore/artistike, punimet e botuara, rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës dhe propozimin e lëmit – fushës së hulumtimit. Intervista me kandidatin është obliguese, por nuk vlerësohet me pikë. Gjatë regjistrimit përcaktohen qartë të gjitha kushtet e domosdoshme për përfundimin e studimeve në kohën e paraparë.

(4) Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje përzgjedhëse janë:

1. Nota mesatare gjatë studimeve themelore dhe Master ka një vlerë maksimale prej 40 pikëve (që shpërndahet përpjestimisht: 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime themelore dhe 20 pikë maksimale për notën mesatare në studime Master), të cilat pikë llogariten në mënyrën si në vijim:

a. Nota mesatare 8 – 8.50: 5 pikë

b. Nota mesatare 8:51 – 9.00: 10 pikë

- c. Nota mesatare 9:01 – 9.50: 15 pikë
- d. Nota mesatare 9.51 – 10.00: 20 pikë
- 1. Magjistratura ose Masteri nga lëmi shkencor ose specializimi nga lëmi i ngushtë shkencor vlerësohet me 5 pikë;
- 2. Aktiviteti kërkimor – shkencor, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me një vlerë maksimale deri në 35 pikë:
  - a. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në Current Contents: autori i parë/ korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.
  - b. Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara: autori i parë 3 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - c. Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendëse, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, dhe që përdorin vlerësimin ose vlerësimin nga kolegët e fushës: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - d. Për libër universitar të botuar në pesë vjetët e fundit nga lëmi i ngushtë: autori ose bashkautori 5 pikë gjithsej.
  - e. Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - f. Për çdo prezantim në formë afisheje të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.

- g. Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendës: autor i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
3. Njohuria e gjuhës angleze ose gjuhës së huaj botërore, relevante për fushën e studimit, deri në 20 pikë maksimale.
  4. Njësitë akademike mund të parashtrojnë për miratim nga Senati kritere shtesë, varësisht nga programi i studimeve të doktoratës.
  5. Në kushte të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.
- (1) Njësitë akademike e propozojnë numrin e studentëve për regjistrim, ndërsa Senati, me propozimin e Këshillit qendror të studimeve të doktoratës e merr vendimin përfundimtar për numrin e studentëve, duke pasur parasysh kapacitetet hulumtuese, mësimore dhe mentoriale të njësisë akademike.
  - (2) Senati i Universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kritereve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në uebfaqen e njësisë akademike dhe në uebfaqen e Universitetit.
  - (3) Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tre vjet, por, për shkaqe të arsyeshme, e për të cilat vendos Këshilli i studimeve të doktoratës, mund të vazhdojnë deri në pesë vjet. Për studentët që e kanë mbaruar magjistraturën shkencore dhe të cilët vazhdojnë studime të doktoratës në lëmin e njëjtë mund të transferojnë deri në 1/3 e numrit të përgjithshëm të kredive të parapara. Për transferimin e kredive vendos Këshilli i doktoratës i njësisë akademike, në bazë të kërkesës së kandidatit. Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita e regjistrimit, doktoranti e humb të drejtën për mbrojtje të punimit të doktoratës, përveç nëse Senati i UP-së, me propozim të KQSD-së dhe duke u bazuar në një arsyetim të dëshmuar të kandidatit, merr vendim tjetër.
  - (4) Në rast se cilësia e punimit të doktoratës, e vlerësuar me raportet

vjetore të progresit, të cilat i zbaton këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike, nuk i plotëson kriteret e parapara, këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike mund t'i propozojë KQSD-së, e ky Senati, të marrë vendim që doktorantit t'ia marrë të drejtën për t'i vazhduar studimet.

## **Fazat e studimeve të doktoratës**

### **Neni 8**

Studimet e doktoratës organizohen në gjashtë semestra:

1. Në semestrin e parë studenti i akumulon 30 ECTS nga provimet e lëndëve profesionale nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar.
2. Në semestrin e dytë, studenti i akumulon 30 ECTS nga seminarët e gruplëndëve të parapara në programin studimor.
3. Në semestrin e tretë studenti i grumbullon 30 ECTS pas vlerësimit pozitiv dhe ratifikimit të projekt-propozimit të doktoratës nga ana e këshillit të doktoratës së njësisë akademike dhe Këshillit qendror për studime të doktoratës, si dhe aprovimit të mentorit nga Senati i Universitetit.
4. Në tre semestrat e mbetur, studenti akumulon 90 ECTS përmes:
  - Së paku një publikimi shkencor të një pjese të rezultateve të doktoratës në një revistë të indeksuar (shih revistat e caktuara nga njësitë akademike) me recension ndërkombëtar nga lëmi përkatës (20 ECTS);
  - Së paku dy prezantimeve në tubime shkencore (konferenca, kongrese, etj.), prej të cilave njëra me karakter ndërkombëtar (10 ECTS);
  - Përfundimit dhe mbrojtjes publike të punimit të doktoratës (60 ECTS).



## **Mentorimi**

### **Neni 9**

- (1) Të drejtë për të udhëhequr kandidat për doktoratë ka:
  1. Mësimdhënësi me titull akademik profesor i rregullt (prof. dr.) ose profesor i asocuar (prof. asoc.), që është në marrëdhënie të rregullt pune në UP;
  2. Përrjashtimisht, me kërkesë të Këshillit të Fakultetit, për mentor mund të angazhohet edhe mësimdhënësi me titull akademik profesor asistent (prof. ass.) nëse ka së paku tri (3) punime të botuara në revista me recension ndërkombëtar. Dëshmia për publikimin e punimeve duhet të sillet në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës;
  3. Mentor, në rast të veçantë, mund të jetë edhe *profesor emeritus*, ndërsa vendimin për këtë e merr Senati, me propozim të këshillit të doktoratës të njësisë akademike në kuadër të së cilës organizohen studimet ose të këshillit të lëmit shkencor.
- (2) Mentori, pa përjashtim, duhet të jetë nga fusha e ngushtë shkencore nga e cila përgatitet doktorata.
- (3) Nëse ka bashkëmentor të jashtëm, ai/ajo duhet ta dorëzojë paraprakisht një CV dhe një letër pëlqimi në këshillin e doktoratës së njësisë akademike.
- (4) Një mentor mund ta marrë për udhëheqje më së shumti dy kandidatë të regjistruar brenda një viti akademik, por jo më shumë se pesë kandidatë njëkohësisht.
- (5) Para se ta marrë detyrën e mentorit për herë të parë, atëherë kur Universiteti e konsideron të nevojshme, secili mentor duhet ta kalojë punëtorinë e mentorimit, të cilën e organizon Universiteti.
- (6) Mësimdhënësi i një njësie akademike të Universitetit të Prishtinës (UP) mund të jetë mentor në ndonjë universitet tjetër, nëse ka miratim me shkrim nga njësia akademike.
- (7) Për mentor nuk mund të propozohet profesori i pensionuar.

- (8) Mentori i cili është emëruar në këtë funksion para se të pensionohet ka të drejtë ta kryejë mentorimin deri në fund.
- (9) Për të siguruar cilësi të punimit të doktoratës, në rast se është nevoja (p.sh. hulumtimi ndërdisiplinor, zhvillimi i kërkimit apo i krijimit artistik në disa institucione), këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike i propozon KQSD-së, e ky Senatit, për të marrë vendim për mentorim të dyfishtë.

### ***Obligimet e mentorit***

#### **Neni 10**

- (1) Mentori e ka obligim ta udhëheqë doktorantin gjatë punës së punimit të doktoratës, ta përcjellë cilësinë e punës së doktorantit, ta përkrahë publikimin e punimeve të tij dhe pjesëmarrjen në projekte shkencore dhe artistike.
